



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:216138

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05490223

CP.nr.1049/2021

GJYKATA THEMELORE MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm me gjyqtarin Genc Hasani dhe me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Tahiri, në lëndën përmbartimore të kreditorëve B. B., N. H., F. H., A.A., I. S., L. A., S. B., M. A., A. Xh., I. Q., të gjithë nga M. të cilët i përfaqëson me autorizim avokat Leutrim Ademi me seli në Mitrovicë, ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës-Drejtoria e Arsimit, lidhur me pagesën e borxhit në baze të dokumentit përmbartimor - Aktgjykimi C.nr. 560/2019, të datës 09.06.2021, të lejuar me aktvendimin për përmbartim CP 1049/21, të datës 01.09.2021, jashtë seance gjyqësore, me datën 22.03.2024 morri këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përmbartimore e udhëhequr sipas shenjës CP 1049/21, me kreditor B. B., N. H., F. H., A.A., I. S., L. A., S. B., M. A., A. Xh., I. Q., ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës, -Drejtoria e Arsimit,” për shkak të pagesës së tërësishme të borxhit nga debitori.

A r s y e t i m

Kreditorët e përmbartimit B. B., N. H., F. H., A.A., I. S., L. A., S. B., M. A., A. Xh., I. Q., të gjithë nga Mitrovica të cilët i përfaqëson me autorizim avokat Leutrim Ademi me seli në Mitrovicë, ka paraqitur propozim për përmbartim në bazë të dokumentit përmbartimor - Aktgjykimi C.nr. 560/19, të datës 09.06.2021.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit të përmbarimit, me aktvendimin CP 1047/21, te datës 01.09.2021, ka lejuar përmbarimin ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës-Drejtoria e Arsimit”.

Pasi aktvendimi për ekzekutim CP 1047/21, te datës 01.09.2021, është bere i ekzekutueshëm, kreditori nëpërmes përfaqësuesit me autorizim me dt. ..., ka njoftuar gjykatën se debitori i përmbarimit e ka përmbushur në tërësi borxhin.

Andaj, borxhi i kërkuar sipas propozimit për përmbarim është përmbushur në tërësi, pasi që debitori ka përmbushur në tërësi obligimin ndaj kreditorit të përmbarimit, gjykata duke u bazuar në nenin 66 paragrafi 4 të LPP-së, në të cilin parashihet se “*Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore*”, vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm

CP.nr.1047/2021 më datë 22.03.2024

Gjyqtari

Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditorë nga dita e pranimit te të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Mitrovicë.